

KASTRIOT PIROLI



Datëlindja: 13.1.1971

Vendlindja: Zhejë, Mamurras,
Kurbini

E-mail: Kastriot.Piroli@parlament.al

Jetëshkrimi:

Ka përfunduar studimet e larta ushtarake. Në periudhën 1989-1993 ka shërbyer si ushtarak aktiv në Akademinë e Forcave Tokësore “Skënderbej”, Tiranë. Në vitet 1993 – 1999 ka qenë oficer, Divizioni Shkodër. Në periudhën 1996 – 1998 ka qenë oficer bazik në fushën e artilerisë në Shkollën e Artilerisë dhe Raketave në terren në Turqi. Në vitet 2004-2005 ka punuar në Bashkinë Mamurras. 2005-2013 ka punuar si zëvendës drejtor i IEVP-së në Shënkoll, Lezhë. Në prill të vitit 2013- nëntor 2013 ka punuar si drejtor i IEVP-së në Shënkoll, Lezhë.

Ka kryer disa trajnime, si: për funksionimin e raketave HJ-8 nga industritë e korporatave të Kinës Veriore (1995), kurs bazik, oficer në fushën e artilerisë dhe trajnim në rolin drejtues të mesëm dhe të lartë në sistemin penitenciar (2005-2013).

Ka qenë anëtar i Partisë Demokratike, 1994, dega Kurbini. Në periudhën 2000-2004 ka qenë kryetar seksioni në Zhejë, Kurbini. Në vitet 2007-2012 ka qenë sekretar grupseksioni në Mamurras, Kurbini. Ka qenë anëtar i kryesisë dega Kurbini për periudhën 2014-2021.